

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK – TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 1 datë 4 .01.2018

**“PËR DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NE FORMË GRANT
/TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR PËR VITIT 2018”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika ç, Ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhezimit nr. 2 date 06.02.2012 ‘Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit’, i ndryshuar, Vendimin Nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik-Tiranë”, grantit te akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise datë 03.01.2017, si dhe me propozim të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për detajimin fondeve të akorduara Universitetit Politeknik, në formë grant/transfertë e pakushtëzuar, për vitin 2018, sipas tabelës bashkangjitur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Gerti JANAQI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Albana KOÇIU

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Jonida TETA

Anëtar
Ardian NACO

Kryetar
Plarent NDRECA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 362/ Prot.
2

Tiranë, më 12 /03 /2018

V E N D I M

Nr. 2 datë 12 . 03. 2018

“PËR
REDUKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50% PËR STUDENTËT
QË NDJEKIN NJË PROGEAM NË CIKLIN E DYTË TE STUDIMEVE DHE QË I
PËRKASIN KATEGORIVE SOCIALE NË NEVOJË PËR VITIN AKADEMIK
2017-2018”,

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 2, 3 pika c/ç, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr. 5171 prot, datë 17.05.2017 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Vendimin nr. 4, datë 08.03.2018 të Senatit Akademik si dhe propozimin e Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:


1. Të miratojë reduktimin e tarifës së shkollimit për studentët që ndjekin një program në ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, në masën 50 %, për vitin akademik 2017 – 2018 për kategoritë e individëve si më poshtë:
 - Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me Vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);
 - Studentët, fëmijë të personave me aftësi të kufizuara të vërtetuara me KMCAP;
 - Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
 - Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të pamjaftueshme për të përballuar koston e studimeve;
 - Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

- Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - Studentët deri në moshën 25 vjeç që janë identifikuar si viktime të trafikut të qeneve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të qënieve njerëzore;
 - Studentët, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror, dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes;
 - Studentët romë dhe ballkano – egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale, si dhe;
 - Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.
2. Studentët e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfitojnë nga reduktimi i tarifës së shkollimit nëse plotësojnë kushtet e percaktuara në rregulloren mesimore për kalimin në vitin pasardhës dhe/ose perfundojnë studimet brenda kohëzgjatjes normale të programit.
 3. Në rast se studenti nuk plotëson kushtet e percaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, humbet të drejtën për të përfituar nga reduktimi i tarifës së shkollimit, për pjesën e mbetur të detyrimit, deri në përfundim të studimit.
 4. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent NDRECA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 637 Prot.

Tiranë, më 04/05/2018

V E N D I M

Nr. 3 datë 04.05.2018

“PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2017 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2018”,

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1/c/ç/h, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 6, datë 26.04.2018 të Senatit Akademik si dhe propozimin e Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:


1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2017;
2. Të miratojë detajimin e buxhetit për vitin 2018 dhe numrin e përgjithshëm të personelit, sipas relacionit dhe pasqyrave bashkëngjitur këtij vendimi;
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent NDRECA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 633 Prot.

Tiranë, më 04/05/2018

V E N D I M

Nr. 4 datë 04.05.2018

**“PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PUNESIMIT NË SEKTORIN E AUDITIT TË
BRENDSHËM”,**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1/f Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe propozimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e punësimit për punonjësit e sektorit të auditit të brendshëm, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi;
2. Të fillojë procedurën për rekrutimin e punonjësve të sektorit Sektorit e Auditit të Brendshëm, sipas rekomandimit të KLSH për ringritjen e këtij sektori;
3. Ngarkohet Administratori i institucionit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent Ndreca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 784/1 Prot.

Tiranë, më 07/06/2018

V E N D I M (Qarkullues)

Nr. 5 datë 07.06.2018

**“PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË KATEGORIVE SOCIALE NË
NEVOJË QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT DHE QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË
PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM
TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018”,**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 3 gërma c/ç, VKM nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, pika 2, VKM Nr. 866, datë 23.10.2015 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 638, datë 22.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016” pika 18, Vendimin Nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën Nr. 2921 Prot, datë 19.03.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve të kategorive sociale në nevojë që plotësojnë kriteret për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit dhe që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve, për vitin akademik 2017-2018, sipas tabelave bashkëlidhur.

2. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Gerti JANAQI



Anëtar
Jonida TETA




Anëtar
Mirela BIMO




Anëtar
Albana Koçiu



Anëtar
Arjan BEQIRAJ




Anëtar
Ardian NAÇO



Kryetar
Plarent NDRECA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 935 Prot.

Tiranë, më 04/07 /2018

V E N D I M

Nr. 6 datë 04.07.2018

**“PËR
MIRATIMIN E FONDIT PËR INVESTIME TË AKORDUAR NGA KOMITETI I
ZHVILLIMIT TË RAJONEVE PËR VITIN 2018 DHE BASHKËFINACIMIN NË
MASËN 30% TË VLERËS SE INVESTIMIT PËR PROJEKTIN RIKUALIFIKIM
I NDERTESAVE TË UPT-SË, (FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE
INXHINIERIA ELEKTRIKE)”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr.109 date 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën e MASR me nr. 6320 prot., datë 08.06.2018 “Detajim i fondit për zhvillimin e rajoneve sipas vendimit nr.7, datë 11.5.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve”, me propozimin e Administratorit, Bordi i Administrimit;


VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të investimeve të akorduara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2018, për projektin “Rikualifikim i ndertesave të UPT-së,(Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Inxhinieria Elektrike)”;
2. Të miratojë financimin në masen 30% të vlerës së investimit, nga të ardhurat e institucionit, për projektin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi;
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent Ndreca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 936 Prot.

Tiranë, më 09 / 07 / 2018

V E N D I M

Nr. 7 datë 04 .07. 2018

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË ANGAZHIMEVE TË AUDITIT PËR VITIN 2018 TË
SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM”,**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe me propozimin e Sektorit të Auditit të Brendshëm me nr. 811 Prot., datë 11.06.2018,

VENDOSI:

1. Miratimin e kryerjes së angazhimeve të auditimit për periudhen e mbetur të vitit 2018, në Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Biblioteken Shkencore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Sektori i Auditit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT



Plarent Ndreca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 947 Prot.

Tiranë, më 05/07/2018

V E N D I M

Nr. 8 datë 05.07.2018

PËR
MIRATIMIN E PLANIT FINANCIAR PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI
GIS DHE MODELIM MINERAR” NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE
MINIERAVE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 3, datë 08.03.2018 të Senatit Akademik;

V E N D O S I:


1. Miratimin e planit financiar për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave në Inxhinieri GIS dhe Modelim Minerar” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

P / Plarent Ndreca

Plarent Ndreca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 948 Prot.

Tiranë, më 05/07 /2018

V E N D I M

Nr. 9 datë 05.07.2018

P Ë R
MIRATIMIN E PLANIT FINANCIAR PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI
INDUSTRIALE" NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE MINIERAVE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës", Vendimin nr. 2, datë 08.03.2018 të Senatit Akademik;

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit financiar për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave në Inxhinieri Industriale" në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

P / Plarent Ndreca





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1021 Prot.

Tiranë, më 18.07 /2018

V E N D I M

Nr. 10 datë 18.07.2018

“PËR
MIRATIMIN E KARTËS SË AUDITIT TË BRENHËM”,

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, me propozimin e Sektorit të Auditit të Brendshëm me nr. 902 Prot., datë 29.06.2018,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Kartës së Auditit të Brendshëm, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi;
2. Ngarkohet Sektori i Auditit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent Ndreca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1022 Prot.

Tiranë, më 17/07 /2018

V E N D I M

Nr. 11 datë 17 . 07 . 2018

PËR
MIRATIMIN E PLANIT FINANCIAR PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË
CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI FIZIKE,
PROFILI FIZIKAN MJEKËSOR” DHE “MASTER I SHKENCAVE NË
INXHINIERI FIZIKE, PROFILI INXHINIER FIZIKE” NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”, Kreu III, pika 1, germa b, si dhe Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 9, datë 14.07.2017 të Senatit Akademik, sipas relacionit të Administratorit;


V E N D O S I:


1. Miratimin e planit financiar për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, Profili Fizikan Mjekësor” dhe “Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, Profili Inxhinier Fizike”, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent Ndreci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1013 Prot.

Tiranë, më 17/07 /2018

V E N D I M

Nr. 12 datë 17.07. 2018

**“PËR
MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK QË ËSHTË
ANGAZHUAR GJATË DITËVE TË LEJES VJETORE NË PROÇESIN E
PRANIMEVE TË STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018”,**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47, neni 49, pika 1, gërma ë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 329, datë 12.4.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 10, Udhëzimi i MASR nr. 15 datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, Udhëzimi i MASR nr. 18 datë 16.08.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 15 datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe propozimin e Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,


VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin e personelit akademik që është angazhuar gjatë ditëve të lejes vjetore, në procesin e pranimeve të studentëve për vitin akademik 2017-2018, sipas relacionit dhe tabelave bashkëngjitur këtij vendimi;
2. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent NDRECAJANE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1022 / Prot. 1

Tiranë, më 17/10/2018

V E N D I M

Nr. 13 datë 17.07.2018

“PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS”,

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika gj, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr.1465 Prot datë 30.11.2017 të Rektorit të UPT, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas dokumentit dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Të propozojë Senatit Akademik, miratimin e statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas pikës 1 të këtij vendimi;
3. Ngarkohet sekretaria e Bordit të Administrimit për zbatimin e këtij vendimi dhe përcjelljen e tij në Senatin Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Plarent Ndreca